



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI**

**Nr.1196 Prot.**

**Tiranë, më 30. 12. 2016**

**Lënda:** Rekomandim për marrjen e masave për zhvendosjen e banorëve të konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri-Turizëm”, si dhe përcaktimin e një afati kohor deri në përgatitjen e dokumentacionit përkatës për përfitimin nga programet e strehimit.

**Drejtuar:** **Z. Blendi KLOSI**  
**Ministër**  
**Ministria e Mirëqënies Sociale dhe Rinisë.**

Adresa: Rruga e Kavajës, 1001, Tiranë.

**Z. Erion VELIAJ**  
**Kryetar**  
**Bashkia Tiranë**

Adresa: Sheshi “Skënderbej”, Nr. 2, Tiranë.

**Të nderuar Zotërinj,**

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi në përmbushje të qëllimit të ligjit nr. 10 221 datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” për të garantuar të drejtën e çdo personi për barazi përpara ligjit, mbrojtje të barabartë nga ligji dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe çdo formë sjellje që nxit diskriminimin dhe bazuar në kompetencën që i jepet në bazë të shkronjës “F”, të pikës 1, të nenit 32, të këtij ligji, për të bërë rekomandime për çfarëdo lloj çështje që lidhet me diskriminimin, parashtron sa më poshtë vijon:

Sipas informacionit të grumbulluar gjatë një takimi, me banorët e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë, përfaqësues të Komisionerit, u bënë me dije se: banojnë afërsisht 35 persona, nga të cilët 14 prej tyre janë fëmijë. Personat e vendosur në këto ambiente ishin vendosur aty prej më shumë se 10 vitesh, por kishte edhe nga ata të cilët banonin aty prej 25 vitesh. Këta persona i përkisnin komunitetit të jetimëve,

të cilët pasi kanë mbushur moshën 18 vjeç, nga ana e strukturave përkatëse shtetërore, janë transferuar nga Shtëpitë e Fëmijëve ( si p.sh.: Shkodër, Sarandë etj.), në ambjentet e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë.

Nga ana e Drejtorisë së Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë, me anë të shkresës nr. 270 prot., datë 22.09.2016, banorët janë bërë me dije se duhet të lirojnë vullnetarisht ambjentet e Konviktit brenda 10 ditëve, pasi ishin bërë pengesë për zhvillimin normal të procesit mësimor të rregjistrimeve të reja. Gjithashtu nga ana e Drejtorisë së Shkollës u është rekomanduar banorëve t’i drejtohen Bashkisë Tiranë për të përfituar nga programet sociale të strehimit.

Gjatë takimeve që kanë patur me përfaqësues të Bashkisë Tiranë, banorët janë informuar verbalisht se duhet të përgatisin dokumentacionin e plotë dhe ta dorëzojnë për të përfituar nga programet e strehimi, si dhe u është lënë kohë deri në fund të muajit Tetor 2016 për të lënë ambjentet e Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë. Gjithashtu, verbalisht nga ana e përfaqësuesve të Bashkisë Tiranë, është dhënë një zgjidhje alternative strehimi, duke i zhvendosur në Qendrën Tranzitore të Emergjencave në Shish Tufinë, por një gjë e tillë nuk është pranuar prej tyre, pasi një prej arsyeve është edhe shkëputja nga shkolla apo kopshtet të fëmijëve që tashmë kanë nisur vitin shkollor dhe e kanë shumë të vështirë përshtatjen në një shkollë tjetër.

Në këto kushte, banorët kërkojnë që nga ana e Bashkisë Tiranë dhe Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, t’i lihet afat deri në fund të vitit 2016, në mënyrë që ata të kenë kohë të përgatisin dokumentacionin për përfitimin nga programet sociale të strehimit.

Kërkojmë nga ana Juaj, që në frymën e respektimit të ligjit dhe të drejtave e interesave të ligjshme të qytetarëve, bazuar në parimin e barazisë dhe pa u diskriminuar, të vlerësoni në mënyrë maksimale problemin dhe shqetësimet e ngritura nga ana e banorëve të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë.

Përsa më sipër, nisur nga situata e konstatuar, si dhe bazuar në kompetencat që neni 32 pika 1/“f” i ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi” i jep institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, por edhe në bazë të Marrëveshjes së Bashkëpunimit që ekziston midis dy institucioneve tona:

### **REKOMANDOJMË:**

1. Ministrisë së Mirëqënies Sociale dhe Rinisë, të marrë masa për shtyrjen e afatit të largimit të banorëve të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë, nga këto ambjente, deri në plotësimin e të gjithë dokumentacionit dhe përfitimin nga programet sociale të strehimit nga ana e Bashkisë Tiranë.



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)

2. Bashkisë Tiranë, të marrë masa për orientimin dhe plotësimin e dokumentacionit përkatës të banorëve të Konviktit të Shkollës së Mesme Profesionale “Hoteleri – Turizëm”, Tiranë, për përfitimin në një nga programet sociale të strehimit.

Për sa më sipër, shpresojmë dhe besojmë në një bashkëpunim sa më të frytshëm ndërmjet institucioneve tona në të ardhmen, duke e vlerësuar maksimalisht mirëkuptimin Tuaj, në mënyrë që institucioni i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi të kryejë detyrat e tij funksionale, në mënyrë sa më korrekte dhe konform ligjeve dhe akteve ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë.

**Irma BARAKU**

---

**KOMISIONERI**

Konceptoi: R. Babaj  
Pranoi: V. Bushati  
Date: 27.12.2016



Adresa: Rruga Sami Frashri, Nr. 10, Kati II, Tiranë  
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)  
Tel: +355 4 2431078  
Fax: +355 4 2431077  
e-mail: [info@kmd.al](mailto:info@kmd.al)  
web: [www.kmd.al](http://www.kmd.al)